



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROÇESVERBAL**

**Nr. 11, datë 31.05.2022**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin maj, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 31.05.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

**Ani Dyrmishi:** Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar Këshilltarë! Të nderuar të pranishëm!

Kryetarja e Bashkisë është duke ardhur pasi kishte një angazhim me Ministren e Arsimit, kështu që ne fillojmë ndërkohë që dhe ajo vjen.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë. I gjithë dokumentacioni Ju është vënë në dispozicion, të cilin e keni marrë nëpërmjet postës elektronike nga sekretaria e këshillit.

Në mbështetje të nenit 73 pika 2 të Rregullores së Këshillit Bashkiak : *”Në rastin kur Sekretari nuk merr pjesë në mbledhje apo në një seancë të mbledhjes për arsyes se nuk është i mundur, Sekretari zëvendësohet përkohësisht nga anëtari i Këshillit më i ri, me të drejte vote”* kështu që për sot sekretaren e zëvendëson këshilltari Jurgen Zaza. Ftoj këshilltarin Jurgen Zaza të bëjë prezencën në sallë.

**Jurgen Zaza:** Faleminderit Kryetar ! Fillojmë.

Jolanda Mustafaraj ... prezent... .....deri tek.... Morena Boja....prezent.....

Kryetar kuorumi është i pranishëm.

(p.s. në listën e apelit janë 37 këshilltarë në sallë, tek pika 3 e R.D largohet nga salla këshilltarja K.Meçi )

**Ani Dyrmishi** : Atëherë meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojme me mbledhjen. Sot për shqyrtim e miratim kemi 19 pika. Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës.

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN MAJ 2022
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të Komisionit Mandateve	PËR MBARIMIN PËRPARA AFATIT TË MANDATIT TË KËSHILLTARIT Z.ELIO JANI
3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN 2, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 30, DATË 26.03.2021, I NDRYSHUAR, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN KASTRATI, RRUGA “RAMADAN VELIU”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË VKB NR.162, DATË 23.12.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PROFESIONAL DHE KONVIKTEVE TË SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE “BEQIR ÇELA” DHE SHKOLLËS SË MESME TEKNOLOGJIKE “HYSEN ÇELA”, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022”, TË NDRYSHUAR
5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PIKËS 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 286, DATË 13.08.2002 “STREHIMIN E FAMILJEVE NË APARTAMENTET E BANIMIT TË MAGAZINAVE TË DUHAN CIGARES NË ZONËN E RRASHBULLIT DURRËS SIPAS LISTËS SË MIRATUAR ME VKM-NË NR.34, DATË 20.01.2001, PËRSA I PËRKET LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE TË STREHUARA NË APARTAMENTET E BANIMIT TË MAGAZINAVE TË DUHAN CIGARES NË ZONËN E RRASHBULLIT DURRËS”, I NDRYSHUAR

<p>6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.2, RRUGA "ISUF MOLLA", PALLATI NR.27, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019</p>
<p>7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1, PJESË PËRBËRËSE E VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77, DATË 28.06.2021, I NDRYSHUAR, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 3, 5, 7, RRUGA "BASHKIMI", PALLATI NR.1, RRUGA "DEMOKRACIA", PALLATI NR. 2/1, RRUGA "PROGRESIT", PALLATI NR. 6, RRUGA "MILLENIUMI" DHE PALLATI NR. 4, RRUGA "MINIERËS", NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019</p>
<p>8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E NJË SHITESË NË ANEKSIN NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 22, DATË 25.02.2021 "PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1062, RRUGA "26 NËNTORI" DHE PALLATIN NR. 14, RRUGA "PETRAQ BOSHNJAKU" NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 2, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019", DUKE PËRFSHIRË Z. FATMIR KOLA</p>
<p>9. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR VITIN 2022 ME VLERË 100'000'000 (NJËQIND MILION) LEKË PA TVSH, NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 291, DATË 11.5.2022 PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.201, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESTA (PALLAT) NË BASHKITË DURRES DHE KAMZË".</p>
<p>10. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E LISTËS ME TRE FAMILJE, PËRFITUESE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË QË I RREZIKOHET JETA DHE PRISHJA E BANESËS SË TYRE, NGA SHEMBJA E DETYRUAR E PALLATIT 25/1, NR.GIS 23179, RR. "HYSEN MYSHKETA", DURRES</p>
<p>11. Shqyrtim dhe miratim i</p>	<p>PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR T'U DREJTUAR KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR NJË NDRYSHIM TË VKM-SË NR. 295, DATË 2.5.2012 "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE</p>

projektvendimit	TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS ISHËM, TË QARKUT TË DURRËSIT”, DHE MIRATIMIN E PËRDITËSIMIT PJESOR TË PASURISË ME EMËRTIMIN KOPSHTI BIZË, QË MBAN NR. 12 TË LISTËS SË TRANSFERIMIT
12. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 21561573.6 (NJËZETË E NJË MILION E PESËQIND E GJASHTËDHJETË E NJË MIJË E PESËQIND E SHTATËDHJETË E TRE PIKË GJASHTË ) LEKË, PËR PASURITË, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION RRUGA APULIA” (PARALEL ME LINJËN HEKURUDHORE – PLAZH)
13. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË SUBJEKTIT PËRFITUES ME NR.RENDOR NR.18, ANEKSI NR.1, PJESË PËRBËRËSE E VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA "LURA", PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA "AHMET DAKLI", PALLATET NR.15&23,TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
14. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR DËME SI PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESAT E TYRE
15. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, DREJTORISË RAJONALE TË MONUMENTEVE TË KULTURËS DURRËS, TË PRONËS ME EMËRTIMIN “VENDSTREHIM”, ME SIPËRFAQE TË PËRGGJITHSHME 155 M <sup>2</sup> (NGA KJO SIPËRFAQE NËN OBJEKT 95 M <sup>2</sup> DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE 60 M <sup>2</sup> ), NË INVENTAR TË NDËRMARRJES RRUGA, PRONË E BASHKISË, QË MBAN NR. 256 TË LISTËS SË PRONAVE, TRANSFERUAR ME VKM-NË NR. 536, DATË 01.05.2008, ME VENDODHJE NË LAGJEN NR. 1, RRUGA “TAULANTIA”, ZK 8512, PËR T’U PËRDORUR PËR MAGAZINIM TË OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, PËR NJË AFAT 1 VIT, ME TË DREJTË PËRSËRITJE

16. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, DREJTORISË RAJONALE TË OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK DURRËS, TE AMBJENTEVE ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 2118 M <sup>2</sup> (NGA KJO, SIPËRFAQE NDËRTIMI KATI PËRDHE: S1= 170 M <sup>2</sup> ; S2= 470 M <sup>2</sup> DHE SIPËRFAQE NDËRTIMI KATI PARË S3=1458 M <sup>2</sup> , DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE 20 M <sup>2</sup> ), ME VENDODHJE NË ISH REPARTIN E URT-SË, PRONË E BASHKISË, PËR NJË AFAT KOHOR 10 VJET
17. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR.55, DATË 26.06.2020 DHE VKB NR.64, DATË 07.07.2020, PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT TË SHKAKTUAR
Shtesa Pika 18. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN ME QIRA, SHOQËRISË “MEDITERRANEAN INVESTMENT GROUP” SHPK, TË PASURISË NR.24/298, ZK 8512, E LLOJIT “TRUALL I LIRE”, ME SIPËRFAQE 346.6 M <sup>2</sup> , ME VENDODHJE NË VENDIN E QUAJTUR RRUGA “EGNATIA”, TRANSFERUAR BASHKISË NË PËRDORIM, PËR NJË AFAT KOHOR 1 (NJË) VIT, NGA FILLIMI I KRYERJES SË PUNIMEVE
Shtesa Pika 19 Informacion këshilltarëve	RAPORT PERFORMANCE VITI 2021, I BASHKISË DURRËS

Atëherë kemi ndonjë koment përsa i përket rendit të ditës?

**Morena Boja** : Po, kam unë një koment përsa i përket rendit të ditës.

**Ani Dyrmishi** : Po.

**Morena Boja** : Referuar Rregullores së Këshillit Bashkiak Durrës maksimumi i pikave që mund të kalohen në një rend dite është 13, kështu që unë do të sugjeroja që në mbledhjet në vazhdim t’i përmbahemi rregullores. Mendoj që 19 pika për miratim janë shumë. Përpos kësaj nëse i referohemi pikës 7, 8, 13 dhe 17 janë pika që i referohen dhe në vendimeve të ndryshimeve të mëparshme, kështu që përveç se do të analizosh relacionin e rendit të ditës duhet t’i referohemi dhe vendimeve të mëparshme kështu themi që janë 19 plus 4 nëse i referohemi dhe vendimeve të mëparshme. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Do ta marrim në konsiderat këtë sugjerim që t'i përmbahemi për rendin e ditës 13 pikave, siç e parashikon neni i rregullores.

Atëherë kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit **numër 1**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale, znj. Klementina Meçi.

**Klementina Meçi**: Faleminderit Kryetar! Përshëndetje të gjithëve!

Komisioni Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës dhe vendosi që të kaloj për miratim me vota unanime në mbledhjen e ditës së sotme. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Ka ndonjë koment përsa i përket pikës 1, nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente s'ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit të **pikës 2**, i japim fjalën Komisionit të Mandateve znj. Ana Dharmo.

**Ana Dharmo** : Faleminderit Kryetar.

Të nderuar këshilltarë, Komisioni i Mandateve u mbledh me mjete të komunikimit elektronik dhe pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur nga Sekretariati i Këshillit Bashkiak për miratimin e dorëheqjes së z.Elio Jani këshilltar i subjektit politik Partia Socialiste në këshill bashkiak, propozon që këtë pikë të kaloj në rend dite duke qënë se këshilltari ka marrë një detyrë tjetër, që është i papajtueshëm me detyrën e këshilltarit. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Ka ndonjë koment përsa i përket pikës 2 të rendit të ditës, nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet pika 2.

(...del nga salla këshilltarja Klementina Meçi...)

**Ani Dyrmishi** : Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 3**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Faleminderit Kryetar.

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim pikën e tre të rendit të ditës, propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

**Etleva Budini** : Faleminderit Kryetar.

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike ka marrë vendimin me vota unanime për të kaluar për votim në këshill bashkiak pikën nr.3.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Budini.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Kryetar përshëndetje, në mungesë time është nënkryetari që do ta japi, se pse nuk kam qënë prezent në komision.

**Ani Dyrmishi** : Atëherë z. Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri**: Komisioni i Zhvillimit Urban u mbledh dhe kalon pikën 3 të rendit të ditës.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Ka komente përsa i përket pikës 3, nga ana e këshilltarëve?

**Etleva Budini** : Po, kam unë.

**Ani Dyrmishi** : Po znj. Budini.

**Etleva Budini** : Unë personalisht kisha një pyetje dhe ndoshta don ndonjë përgatitje, por gjithsesi unë po e bëj, nëse nuk mundën sot dhe s'ka nga stafi i bashkisë sot, të më përgjigjen në mbledhjen e ardhshme.

Normalisht unë e kam shprehur dhe herë të tjera që jam pro në çdo rast, të çdo përfituesi dhe nuk i hy kësaj fare, por në këtë rast do kemi një ndryshim të Vendimit nr.30 të Këshillit Bashkiak, datë 26.03.2021 dhe pyetje për stafin e bashkisë : Pse nuk është përfshirë në listën e parë fituese dhe pse është përfshirë tani? Thjesht një sqarim se në rastin kur nuk është fitues nuk kemi sqarime për jo fituesit. Këtë herë çfarë pashë nga raportet nuk është se ka ndonjë sqarim, pse është fitues këtë herë. Nëse mundeni të më jepni përgjigje që këtë radhë mirë, nëse jo kalojmë.

**Ani Dyrmishi** : Ka ndonjë nga bashkia?  
Po z.Pronjari.  
Mund të afrohesh këtu Ermal te mikrofonin.

**Ermal Pronjari** : Mirëdita të gjithëve!  
Këto janë përfshirë tani sepse më parë kanë pas probleme me dokumentacionin, pra dëshmi trashëgimie pasi kanë qënë shumë bashkëpronar dhe pas kërkesave të bëra janë përfshirë në listën fituese. Ka dhe shumë të tjerë...

**Etleva Budini** : Pra pas kërkesave ka plotësuar dokumentacionin.

**Ermal Pronjari** : Po, ka plotësuar dokumentacionin.

**Etleva Budini** : Në rregull, faleminderit.

**Ermal Pronjari** : Asgjë.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit z.Pronjari.  
Atëherë koment tjetër për pikën 3 nga ana e këshilltarëve kemi?  
Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

**Artion Beqiraj** : Kryetar, Kryetar, kam një pyetje .

**Ani Dyrmishi** : Po z. Beqiraj.

**Artion Beqiraj** : Në të njëjtin pallat ka më shumë persona të trajtuar apo kanë akoma që duhet të sjellin dokumenta. Në mënyrë të përgjithshme për rastin.

**Ermal Pronjari** : Bëhet fjalë për pallatin “Kastrati” këtu. Shumica e personave janë trajtuar dhe shumë pak mund të jenë, 4-5 familje që mund janë duke plotësuar dokumentacionet e nevojshme për të kaluar, sipas aktit normativ, shumë pak dhe tek 4 pallatet tek “Lura” e njëjta gjë , tek lagjja 17.

**Ani Dyrmishi** : Ka pyetje të tjera përsa i përket pikës 3? Nuk ka.  
Atëherë kush është pro miratimit të pikës 3?  
Kundra?....  
Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet pika 3 e rendit të ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 4**, i japim fjalën Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, znj.Jolanda Mustafaraj.



**Jolanda Mustafaraj** : Përshëndetje të gjithëve!

Komisioni u mbledh dhe mori vendim dhe ra dakort për ndryshimin e këtij vendimi të këshillit bashkiak. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Mustafaraj.

Ka komente përsa i përket pikës 4, nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 4 e rendit të ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 5**, i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

**Etleva Budini** : Atëherë Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve votuan unanimitisht për kalimin e pikës nr. 5 për votim në këshill bashkiak.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Budini.

Kemi komente përsa i përket pikës 5, nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 5.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 6**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi**: Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike për pikën 6 mori në shqyrtim relacionin dhe projektvendimin dhe propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini**: Gjithashtu dhe Komisioni Strehimit mori vendim unanimitisht të 8 anëtarët për ta kaluar për votim në këshill bashkiak.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës z. Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri**: Komisioni i Zhvillimit Urban vendosi unanimitisht për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Kemi komente përse i përket pikës 6, nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 6 e rendit të ditës

- Kalojmë në **pikën 7** të rendit të ditës, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi**: Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike dhe për pikën 7 pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini** : Gjithashtu dhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike pas shqyrtimit të relacionit dhe projektvendimit vendosi unanimit për ta kaluar për votim në këshill bashkiak këtë pikë.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Budini.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës z. Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri**: Gjithashtu dhe Komisioni i Zhvillimit Urban vendosi unanimit për ta kaluar në votim pikën 7.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Përse i përket pikës 7, kemi komente nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 7 e rendit të ditës

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 8** të rendit të ditës, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi**: Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike dhe për pikën 8 propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini** : Gjithashtu dhe Komisioni Strehimit vendosi unanimitisht për ta kaluar për votim në këshill bashkiak pikën 8.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Budini.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës z. Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri**: Gjithashtu dhe Komisioni i Zhvillimit Urban vendosi unanimitisht për ta kaluar në votim pikën 8.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 8, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 8 e rendit të ditës .

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 9**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Pamela Bardhaj.

**Pamela Bardhaj** : Komisioni ynë vendosi me të gjitha votat pro miratimit të kësaj pike. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës z. Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri**: Gjithashtu dhe Komisioni i Zhvillimit Urban vendosi unanimitisht për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 9, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 9 e rendit të ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 10**, i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini** : Atëherë Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve vendosi unanimitisht për ta kaluar në votim këtë pikë të rendit të ditës.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 10, nga ana e këshilltarëve kemi ?

Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 10 e rendit të ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin për **pikën 11**, i japim fjalën Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, z. Mullaraj.

**Alfred Mullaraj**: Komisioni ishte dakort me këtë pike, unanimitet të gjithë.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 11, nga ana e këshilltarëve kemi ?

Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 11 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 11.

- Kalojmë në shqyrtimin për **pikën 12**, i japim fjalën Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, z. Mullaraj.

**Alfred Mullaraj**: Edhe për këtë pikë ishte dakort gjithë komisioni në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit z. Mullaraj.

Komente përsa i përket pikës 12, nga ana e këshilltarëve kemi ?

Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 12 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 12 e rendit të ditës.

- Kalojmë në **pikën 13** të rendit të ditës, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi**: Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike dhe për pikën 13 propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini** : Gjithashtu dhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike vendosi për ta kaluar sot për votim në mbledhjen e këshillit bashkiak.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Budini.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës z. Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri**: Gjithashtu dhe Komisioni i Zhvillimit Urban vendosi unanimisht për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Përsa i përket pikës 13, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 13 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 13 e rendit të ditës .

- Kalojmë në shqyrtimin për **pikën 14**, i japim fjalën Komisionit të Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë z. Afrim Bakaj.

**Afrim Bakaj**: Edhe Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë ishte dakort që kjo pikë të kalojë për votim me shumicë votash.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Ka komente përsa i përket pikës 14?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 14 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 14 e rendit të ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin përsa i përket **pikës 15**, i japim fjalën Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, z. Mullaraj.

**Alfred Mullaraj**: Edhe për këtë pikë Komisioni ishte dakort të kalojë në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Përsa i përket pikës 15, kemi komente nga ana e këshilltarëve ?

Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 15 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 15 e rendit të ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 16**, i japim fjalën Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, z. Mullaraj.

**Alfred Mullaraj:** Edhe për këtë pikë Komisioni ishte dakort për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Përsa i përket pikës 16, kemi komente nga ana e këshilltarëve ?

Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 16 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 16 e rendit të ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin për **pikën 17** të rendit të ditës, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi:** Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim këtë pikë për ndryshimin e VKB-ve përsa i përket listës emërore, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit znj Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini:** Gjithashtu dhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike vendosi për ta kaluar në votim në mbledhjen e sotshme të këshillit bashkiak të kësaj pike të rendit të ditës.

**Ani Dyrmishi :** Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës z. Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri:** Gjithashtu dhe Komisioni i Zhvillimit Urban vendosi unanimit për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Përsa i përket pikës 17, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim pra.

Kush është pro miratimit të pikës 17 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Me vota unanime miratohet dhe pika 17 e rendit të ditës .

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 18** të rendit të ditës, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi:** Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim projektvendimin dhe relacionin në lidhje me dhënien me qera të tokë-truall e lirë shoqërisë “Mediterranean Investment Group”, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi** : Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, z.Alfred Mullaraj.

**Alfred Mullaraj**: Edhe Komisioni jonë ra dakort për ta kaluar në votim këtë pikë.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Kemi ndonjë koment përsa i përket kësaj pikës?

**Artion Beqiraj** : Një pyetje kam

**Ani Dyrmishi** : Po.

**Artion Beqiraj** : Unë jam dakort me projektvendimin, por doja të dija. Kjo sipërfaqe trualli çfarë qëllimi do të ketë në këtë investim? Flitet që do t'i shërbej investimit, por çfarë qëllimi ka, sepse citohet dhe kontrata e bashkëngjitur e qerasë, por unë se gjeta tek materiali.

Nëse ka informacion.

**Ani Dyrmishi** : Përfaqësuesi i bashkisë për të kthyer përgjigje përsa i përket kësaj pike .

Po z. Isaku .

**Arben Isaku** : Atëherë “Ne” këtë tokë e kemi në përdorim, pra e ka këshilli bashkiak dhe ...

**Ani Dyrmishi** : Z. Isaku afrohu këtu tek mikrofon.

**Arben Isaku** : Atëherë me Vendim të Këshillit të Ministrave “Mediterranean Investment Group” është shpallur si investitor strategjik dhe ka marrë lejen në KKT për të ndërtuar një hotel me 5 yje në zonën ku do të jepet dhe pjesa e truallit që institucioni i bashkisë ka në përdorim. “Ne e kemi dhënë me një periudhë 1 -vjeçare me qera. Kush ishte pyetja më në detaje?

**Artion Beqiraj** : Çfarë qëllimi ka ? Nëse do të jetë e lirë më pas?

**Arben Isaku** : Kjo jepet me qera në mënyrë që ai të ketë hapsirë në momentin që do të zbatohet lejen e ndërtimit.

**Artion Beqiraj** : Më pas do të kthehet e lirë ?

**Arben Isaku** : Po, do të kthehet e lirë.

**Alneida Rroshi** : Mundem, mundem Kryetar. Mundem ta sqaroj Kryetar.

**Ani Dyrmishi** : Po.

**Alneida Rroshi:** Unë pasi e kam lexuar gjithë projektin që ato do të zhvillojnë. Ata kanë fituar një status të veçantë dhe do ta përdorin sheshin për të vënë mjetet e punës. Mjetet e punës kërkojnë një ambient të konsiderueshëm dhe 20 %-shin ja kanë kërkuar bashkisë Durrës për të vendosur mjetet e punës. Është menduar 1 vit, sepse është fillimi i zhvillimit të aktivitetit të tyre për hotelin me 5 yje dhe për këtë arsye kanë kërkuar këtë 20 %-sh nga Bashkia Durrës. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Je i qartë Artion?

**Artion Beqiraj :** Po.

**Ani Dyrmishi :** Atëherë koment tjetër ka ?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 18 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 18 e rendit të ditës.

- **Për pikën 19**, i jap fjalën Drejtoreshës së Buxhetit pranë bashkisë Durrës znj.Valbona Qirjako të na informoj shkurtimisht për “Raportin e Performancës së Bashkisë Durrës për vitin 2021”.

**Valbona Qirjako:** Raporti i performancës jep një pasqyrë të përgjithshme të realizimit të programeve buxhetore gjatë vitit 2021. Në këtë raport kemi dhënë disa tregues performance për ato programe buxhetore që zënë peshën më të madhe në buxhet. Aktualisht po punojmë që çdo program buxhetor të ketë disa tregues performance.

Sikurse e kemi thënë edhe në raport buxheti i bashkisë Durrës në fund të vitit 2021 rezulton të ketë alokuar rreth 4% më shumë fonde sesa një vit më parë duke reflektuar kështu rritjen e burimeve të financimit.

Përgjatë vitit 2021 financat e bashkisë janë karakterizuar nga:

- ✿ Përgjysmimi i fondeve për investime kundrejt një viti më parë.
- ✿ Mbështetje me shërbime të menaxhimit të mbetjeve urbane dhe rritjet rrugor duke zënë një peshë nga më të lartat në buxhetin e bashkisë, rreth 17% të buxhetit secila nga këto programe.
- ✿ Rritja e rëndësishme e të ardhurave të veta në totalin e burimeve të financimit të bashkisë.

Ekzekutimi i buxhetit ka arritur të përdorë të gjitha të burimet e financimit, duke arritur eficiencë në përdorimin e tyre në kohë sipas planifikimit buxhetor.

*Të ardhurat e veta të bashkisë:* Bashkia mbështetet në pothuajse gjysmën e buxhetit të saj nga nga transfertat e qeverisë qendrore. Të ardhurat nga burimet e veta të financimit janë rreth 50% e totalit të të ardhurave.



Pesha e të ardhurave nga burimet e veta është rritur.

- ✿ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë janë rritur me 17 % kundrejt vitit 2020 dhe u realizuan në masën 94 % të planit.
- ✿ Të ardhurat nga burimet e veta të bashkisë u rritën në total me 42 % kundrejt një viti më parë dhe kjo si rrjedhojë e mirëmenaxhimit të të ardhurve vendore nga administrata fiskale e bashkisë.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 shënuan rritje kundrejt vitit 2020 me rreth 4 %, duke reflektuar kështu rritjen e burimeve të financimit kryesisht nga të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifat vendore, ndërkohë që realizimi i tyre kundrejt planit të vitit 2021 ishte rreth 70 %, ose një mosrealizim prej 30 % i planit të bashkisë si rrjedhojë e investimeve që nuk janë realizuar në arsimin parashkollor dhe atë bazë , pasi këtu është dhënë prioritet atyre financimeve që janë bërë në kuadër të procesit të rindërtimit po që nuk janë më fonde të bashkisë, por janë me fonde të qeverisë qendore apo të donatorëve.

*Bashkia ka investuar me fondet e veta për përmirësimin e shërbimeve publike një fond prej 551 milionë lekë. Kundrejt vitit 2020 investimet kanë rënë me rreth 16 %, për rrjedhojë edhe kontributi i tyre në buxhet është zvogëluar. Ndërkohë që realizimi i investimeve me të ardhurat e Bashkisë për vitin 2021 kundrejt planit është në masën 43 %. Këtë vit i është dhënë prioritet investimeve për rindërtimin, të cilat nuk janë paraqitur në këtë raport. Gjatë vitit 2021, për procesin e rindërtimit, me fondet e qeverisë qendrore, janë investuar 1.34 miliard lekë.*

*Menaxhimi i mbetjeve është një nga programet kryesore të buxhetit të bashkisë.*

Investimet këtu zënë në fund të vitit 2021 rreth 22 % të buxhetit të bashkisë dhe janë një peshë e moderuar në totalin e shpenzimeve të bashkisë. Fokusi i investimeve janë shërbimet e infrastrukturës rrugore, menaxhimit të mbetjeve, shërbimet publike, ndriçimi rrugor, strehimi social, arsimi bazë dhe parashkollori etj.

Bashkia ka realizuar shpenzime për grumbullimin, transferimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane në qytet dhe njësitë administrative si edhe pastrimin e rrugëve në pjesën urbane të bashkisë në masën 87 % të planit buxhetor. Bashkia shpenzon rreth 17 % të buxhetit për këtë shërbim. Performanca e shërbimit tregon se:

- ✿ Është ruajtur frekuenca e tërheqjes së mbetjeve nga kazanat e grumbullimit që ka vendosur bashkia, 1 herë në ditë në zonën urbane dhe 2 herë në javë në zonën rurale .
- ✿ Bashkia ka rritur grumbullimin e të ardhurave nga tarifa e shërbimit të pastrimit të qytetit duke arritur një normë arkëtimit e cila bën që të rritet edhe mbulimi i kostove nga të ardhurat e tarifës nga 22 % që ishte në vitin 2020 në masën 63 % në vitin 2021. Gjithësesi mbulimi i këtyre kostove mbetet ende larg nivelit të synuar i cili duhet të jetë 100%.
- ✿ Mbetjet janë dërguar në landfillin e Sharrës, i cili është kthyer tashmë në një vend depozitimi rajonal për qarkun e Tiranës dhe Durrësit, ku sot jo vetëm bashkia jonë depoziton aty, por edhe bashki të tjera të qarkut si Kamëza, Vora, Kavaja etj. Tarifa e depozitimit në Sharrë është financuar nga Qeveria qendrore, kurse transporti është financuar tërësisht nga të ardhurat e bashkisë.
- ✿ Kjo ka bërë që edhe buxheti për këtë program buxhetor të rritet në mënyrë të rëndësishme.

*Arsimi parashkollor dhe bazë:* Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në masën 63% të planit. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 14 % të buxhetit të saj.

Performanca e shërbimit gjatë vitit 2021 tregon se:

- ✿ Është ruajtur niveli i frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë në masën 100 % të fëmijëve, që kanë moshën e duhur për të ndjekur sistemin parashkollor dhe atë bazë.
- ✿ Është ruajtur norma mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues.
- ✿ Është rritur financimi i institucioneve arsimore duke synuar përmirësimin e kushteve të mësimit si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit.

Përgjatë këtij vitit janë përmirësuar shkollat 9 vjeçare të bashkisë në: Hamallaj, Kucok, Ndraç, Ishëm, Fshat Rinia, në Shën Vlash, si edhe kopshtet si: Gjuricaj, Neim Babameto, Isuf Ferra.

*Ndriçimi i rrugëve:* Bashkia ka realizuar shpenzime për ndriçimin e hapësirave publike duke paguar faturat e energjisë elektrike si edhe mirëmbajtjen dhe investime në sistemin ndriçues të hapësirave publike në masën 76 % të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 5 % të buxhetit të saj për këtë shërbim. Investimet e rëndësishme në ndriçimi në hapësirat publike kanë çuar në përmirësimin e performancës së këtij shërbimi, i cili tregon se: Janë shtuar hapësirat publike të ndriçuara, ku është shtuar edhe sistemi LED, që ofron një eficiencë të energjisë elektrike.

Është për t'u përmendur ndriçim i ri tërësisht në lagjen Abaz Çelkupa, që u përfundua me sukses gjatë vitit 2021 si edhe projektet e ndriçimit në rrugët: Hysen Mushketa, Vëllazërimi, Kristo Sotiri, të cilat do të përfundojnë gjatë vitit 2022.

Këto ishin disa nga programet kryesore, që zënë dhe peshën më të madhe në buxhet për vitin 2021. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Qirjako.

Ka ndonjë pyetje përsa i përket informacionit.

Po, Kërtusha.

**Klodian Kërtusha** : Thatë që 5 % e buxhetit janë shpenzime për ndriçimin, përshëmbull për të paguar faturat e enegjisë. Doja të bëja një propozim për të mirën e apo edhe për efijencën. Kisha një propozim që bashkia e Durrësit të bëj një investim për ndriçuesit me panele diellor, për arsye se dhe konsumi eliminojmë tërësisht harxhimin e këtij buxheti për konsumin e energjisë. Do ishte propozim nga ana ime.

**Valbona Qirjako**: Nuk jam unë specialistja e Drejtorisë së Ndriçimit, por di që në bashkëpunim me Ministrinë e Energjetikës dhe Infrastrukturës do hartohet një masterplan për ndriçimin e qytetit, në të cilët do të shikohet se cilat do të jenë mënyrat e ndriçimit në qytet, por përgjigjen më të saktë mund ta japë Drejtoria e Shërbimeve.

**Klodian Kërtusha** : Në buxhetin e këtij viti kemi miratuar ndriçimin e 11 rrugëve që do të bëhen investime të rrugëve me ndriçues LED shumë mirë okey është, por nëse dhe në këto investime do të futeshin dhe panelet diellor, kosto e shpenzimit mund të shkojë e njëjta gjë me .. dhe pjesa e çmimit ke kostot e shpenzimeve për harxhimin për faturat e energjisë në këtë buxhet mund të transferohet për diçka tjetër. Kjo është propozim nga ana ime, si pjesë e fushës që jam.

**Valbona Qirjako**: Do t'ja përcjell Drejtorisë së Ndriçimit Rrugor, që ta kenë parasysh kur të hartohet buxheti për vitin 2023-2025.

**Klodian Kërtusha** : Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Ndonjë pyetje tjetër ka?

**Morena Boja** : Kam dhe unë një pyetje.

Gjatë leximit të raportit përmendet që në të ardhurat e buxhetit të bashkisë Durrës janë të ardhura lokale dhe ndërsa gjysma tjetër janë të ardhura nëpërmjet transfertave qeveritare. Unë doja të dija nëse bashkia Durrës ka ndonjë plan për rritjen e të ardhurave lokale duke marrë në konsideratë që është e dyta më e madhja në vënd ka resurse, dhe ka prona apo burime të tjera që mund t'i menaxhojë që të gjenerojnë dhe të ardhura .

**Valbona Qirjako**: Përgjigjen për këtë duhet ta jap Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe unë nuk jam në gjëndje të jap një përgjigje se si, pasi ajo është drejtoria përkatëse që merret me planifikimin dhe resurset që ka bashkia, kapacitetet e saj për rritjen e të ardhurave.

**Morena Boja** : Në rregull, faleminderit. Mund të ma jepni dhe në mbledhjen tjetër.

**Ani Dyrmishi** : Morena, në rregull në mbledhjen e ardhshme.

**Morena Boja** : Kam dhe diçka “Ne” në mbledhjet e Këshillit Bashkiak kalojmë prona që okey, mund të jenë dhe institucione që janë në varësi, por janë institucione që gjenerojnë të ardhura dhe ndërkohë bashkia i vë në dispozicion prona pa kundërshtëpërblim dhe mendoj se duhet riparë dhe menaxhimi i këtyre pronave publike. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Do të mbahen shënime pyetje në sekretariat dhe besoj do të kemi përgjigje për pyetjet që Ju shtruat.

Atëherë fjalën e ka ? Po Klodi dhe njëherë.

**Klodian Kërtusha** : Kam një pyetje që nuk ka lidhje me rendin e ditës.

**Ani Dyrmishi** : Znj. Qirjako mund të vazhdoni, faleminderit.

**Klodian Kërtusha:** Në zonën që unë përfaqësoj një pjesë e madhe kanë shprehur një shqetësim, që për mua është i drejtë. Bëhet fjalë për emërtimin e disa rrugëve që ato nuk i pranojnë.

Kemi 2 raste, një rast është në një fshat, lagje e cila, ajo lagje është krijuar në vitin 1760 dhe pas 12 vitesh i ndryshohet emërtimi me një emërtim X. Dhe rasti i dytë që për mua është totalisht i paparanueshëm si dhe pjesë ligjore flas, ku kemi rrugën në hyrje në njësinë administrative Ishëm që ka emërtimin e një individi që është gjallë, një ish kryetar komune dhe gjithë zona mban po këtë emër dhe i bie që “Ne” të vendosim emërtime rrugësh çka janë kryetar komunash e vazhdim.

**Ani Dyrmishi :** Këtë do ta mbash shënim si këshilltarë që je dhe do i drejtohesh drejtorisë për ndryshime përkatëse sipas procedurave ligjore.

Atëherë diskutim tjetër s’kemi sot.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ju faleminderit të gjithëve.

*Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 20 (njëzet) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit.*

**Mbajtësi i procesverbalit:** Jurgen Zaza

**Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :**

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendësues i Sekretares së Këshillit Bashkiak :

JURGEN ZAZA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI